



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 1, datë 14.01.2022

MBI
SHTYRJEN E AFATIT TË RAPORTIMIT

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2 dhe 22, të Ligjit nr. 9572 datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

Shoqëritë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe shoqëritë administruese të fondit të pensionit, duhet të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore të paaudituar deri më datë 15 janar, bazuar në nenin 203, të Ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, nenin 11, të Rregullores nr. 107, datë 30.06.2021 “Mbi përmbajtjen, afatet kohore dhe formën e raporteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, shoqërive administruese dhe depozitarëve”, si dhe neneve 75, 76, të Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar” dhe nenit 7, të Rregullores nr. 25, datë 23.02.2011 “Për raportimin në AMF të veprimtarisë së shoqërisë administruese të fondeve të pensionit”.

Autoriteti, është bërë me dije, se disa shoqëri administruese kanë vështirësi për raportimin brenda këtij afati, për shkak të kufizimit të numrit të punonjësve, si rezultat i rritjes së numrit të të infektuarve nga Covid-19.

Në këto kushte, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e shtyrjes së afatit të raportimit të pasqyrave financiare vjetore të paauditura të shoqërive administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe shoqërive administruese të fondeve të pensionit, deri më datë 31 janar 2022.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Fondeve, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Olsi ÇOKU

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin METE